

# THIRRJE PËR MENAXHER/E TË RRJETEVE SOCIALE



## Kush jemi ne?

Qendra "Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim" (SCiDEV është një organizatë jofitimprurëse dhe jopartiake e cila synon të mbështesë dhe inkurajojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social si dhe të mbështesë demokratizimin e vazhdueshëm në Shqipëri dhe në rajon. Për ta arritur këtë, SCiDEV punon me akademinë, shoqërinë civile, institucionet private dhe publike, në forcimin e inovacionit dhe kërkimit shkencor, advokimin dhe mbështetjen e përdorimit të evidencave për iniciativat ligjore dhe rregullatore, si dhe ndërmarrjen e aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve për të forcuar institucionet publike dhe private, institucionet e arsimit të lartë, mediat dhe të tjerë aktorë të shoqërisë civile.

SCiDEV është në kërkim të një Menaxheri/eje të rrjeteve sociale me kohë të pjesshme, i/e cila përshtatet lehtësisht me zhvillimet e shpejta dhe dinamikat e organizatës. Si Menaxher/e e rrjeteve sociale, ju do të luani një rol kyç në hartimin dhe zbatimin e strategjive të vizibilitetit për rritjen e përfshirjes së audiencës në rrjetet sociale, si dhe koordinimin e eventeve.

## Përgjegjësitë

- Harton dhe zbaton strategjinë e mediave sociale për të rritur vizibilitetin e organizatës dhe shtuar përfshirjen e audiencës sonë të synuar.
- Krijon dhe përzgjedh përmbajtje tërheqëse për platformat tona të mediave sociale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, Facebook, Instagram, Twitter dhe LinkedIn.
- Planifikon dhe publikon postimet në media sociale, duke siguruar që ato të jenë në kohën e duhur, relevante dhe të plotësojnë udhëzimet e organizatës.
- Monitoron kanalet e rrjeteve sociale për vlerësime, komente dhe mesazhe, dhe përgjigjet në kohë reale dhe në mënyrë profesionale.
- Koordinon evente sipas rastit, duke përfshirë planifikimin, logjistikën dhe promovimin.
- Bashkëpunon me ekipin e komunikimit për të siguruar që kontenti në rrjete sociale dhe eventet të përputhen me objektivat e përgjithshme të komunikimit.
- Analizon dhe raporton mbi statistikën e rrjeteve sociale dhe eventeve, duke përfshirë audiencën e arritur, nivelin e angazhimit, pjesëmarrjen si dhe përdor të dhënat për të hartuar strategjitë e ardhshme.
- Çdo angazhim tjetër si pjesë e pozicionit.

## Kriteret që duhet të përmbushin aplikantët

- Përvojë e mëparshme pune si Menaxher/e i rrjeteve sociale apo në pozicione të ngjashme.
- Njohuri të shkëlqyera të platformave dhe trendeve të rrjeteve sociale.
- Përvojë në krijimin dhe editimin e përmbajtjes vizuale, foto dhe video.
- Aftësi të forta komunikimi me gojë dhe shkrim.
- Zotërim i gjuhës shqipe dhe angleze.
- Mendim kreativ dhe inovativ me pasion për rrjetet sociale dhe planifikimin e eventeve
- Aftësi për të bërë shumë detyra në të njëjtën kohë dhe të prioritzojë projektet me efektivitet.
- Përvojë me mjete analitike të rrjeteve sociale dhe software për menaxhimin e eventeve.
- Preferohet të zotërojë Bachelor në Marketing dhe/ose Komunikim apo fusha të tjera relevante.

## Çfarë ofrojmë dhe si të aplikoni për pozicionin?

Ne ofrojmë mundësi për zhvillim profesional, mentorim nga profesionistë me përvojë të komunikimit dhe drejtues të OJQ-ve dhe akses të vazhdueshëm në mundësi trajnimi. Do të keni mundësinë të angazhoheni në fusha të tjera të punës së organizatës dhe të zgjeroni aftësitë dhe njohuritë tuaja.

Ky është një pozicion me kohë të pjesshme me orë fleksibël. Nëse jeni një profesionist i ri i/e motivuar me pasion për mediat sociale dhe koordinimin e ngjarjeve, ju inkurajojmë të aplikoni! Ju lutemi dorëzoni CV-në tuaj dhe letrën e motivimit për shqyrtim.

Dërgoni CV-në tuaj dhe Letër Motivuese në [info@scidevcenter.org](mailto:info@scidevcenter.org) deri më 28 Prill 2023.

Ju mirëpresim në ekipin tonë!